

I.3.1 SISTEMI I PAGESAVE

- *Reformimi dhe mbikëqyrja e sistemeve të pagesave po zë gjithmonë e më shumë hapësira në strategjitë e zhvillimit të bankave qendrore, sidomos pas efekteve të evidentuara në infrastrukturën e tregjeve financiare, gjatë krizës financiare globale. Parimet mbikëqyrëse të infrastrukturës së tregjeve financiare, të publikuara nga Banka Ndërkombëtare për Rregullim (BIS) në prill të vitit 2012, nënvizojnë nevojën e bankës qendrore për të mbështetur funksionin mbikëqyrës të sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes me një mandat të qartë ligjor. Me qëllim materializimit e nevojave të sipërcituara në ambientin shqiptar, Banka e Shqipërisë ndërmori hapat e nevojshëm për hartimin dhe miratimin nga Kuvendi i Shqipërisë, të ligjit 133/2013, datë 29.04.2013, "Për Sistemin e Pagesave" .*

Ligji "Për Sistemin e Pagesave" synon të mandatojë Bankën e Shqipërisë, nëpërmjet një kuadri ligjor të posaçëm për rregullimin, licencimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave, në përputhje me objektivat ligjore të këtij institucioni. Miratimi i ligjit nënkupton liberalizimin e tregut të sistemeve të pagesave, nëpërmjet krijimit të sistemeve private të pagesave. Ligji "Për Sistemin e Pagesave" synon të nxisë sigurinë, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e sistemit kombëtar të pagesave në Shqipëri, edhe nëpërmjet përcaktimit të mjeteve, procedurave dhe rregullave për finalitetin e shlyerjes në sisteme, si dhe marrëveshjet e kolateralit financiar. Më konkretisht, ligji synon të minimizojë rrezikun sistemik, i cili lidhet me pjesëmarrjen në sistemet e pagesave dhe të shlyerjes së titujve, dhe në veçanti rreziqet që lidhen me paaftësinë paguese të një pjesëmarrësi në sistem. Në lidhje me kolateralin financiar, ai ofron një kuadër ligjor kombëtar të aplikueshëm për krijimin, vlefshmërinë dhe realizimin e disa llojeve të marrëveshjeve të kolateralit financiar. Gjithashtu, ai synon të minimizojë pengesa të mundshme në funksion të përdorimit me efikasitet të marrëveshjeve të kolateralit financiar. Realizimi i objektivave të lartpërmendura është arritur nëpërmjet implementimit në kuadrin ligjor vendas, të dy direktivave tejet të rëndësishme në fushën e pagesave, atë "Mbi finalitetin e shlyerjes së pagesave në sistemet e shlyerjes së pagesave dhe të letrave me vlerë" (direktiva 98/26/EEC) dhe "Mbi kolateralin financiar" (direktiva 2002/47/EC).

Miratimi i ligjit "Për Sistemin e Pagesave", krijoi hapësirën e nevojshme për rregullime të sistemeve kombëtare të pagesave, nëpërmjet akteve të posaçme nënligjore. Në këtë kuadër, me vendimin nr. 42, datë 26.06.2013, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, u miratua rregullorja "Për rregullimin, licencimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të skemave kombëtare të pagesave". Rregullorja, synon të krijojë hapësirat e përshtatshme, me qëllim nxitjen e iniciativave private për krijimin e infrastrukturave të nevojshme në tregun vendas të pagesave me kartë. Më konkretisht, dispozitat e rregullores për licencimin e operatorëve të skemave të pagesave me kartë, i japin të drejtën personave juridikë të krijojnë skema kombëtare të pagesave me kartë, duke përfshirë edhe rolin e procesorit kombëtar. Në këtë kontekst, krijimi i këtij akti rregullativ, synon të nxisë konkurrencën në tregun shqiptar të kartave dhe si rrjedhojë, të ulë kostot e mbartura nga pagesat me kartë në tregun vendas. Ky treg, deri më tani, mbizotërohet nga kompani të mëdha me aktivitet ndërkombëtar.

Përçimi, në praktikë në tregun shqiptar, i masave të sipërcituara është materializuar nëpërmjet licencimit të operatorit të parë të skemës kombëtare të pagesave me kartë, në muajin tetor të vitit 2013.

Në këtë drejtim vlen për t'u theksuar se, krijimi i kuadrit rregullativ dhe licencimi i operatorit të skemës kombëtare të pagesave me kartë përbën hapin e parë të Bankës së Shqipërisë drejt rregullimit, licencimit dhe mbikëqyrjes së të gjithë elementëve të rëndësishëm të sistemeve të pagesave.

Në perspektivën e zhvillimeve infrastrukturore, vlen për t'u nënvizuar se Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë dy projekte të rëndësishme, të cilat priten të sjellin përmirësime në infrastrukturën e tregut financiar. Përgjatë vitit 2013, Banka e Shqipërisë ka fokusuar përpjekjet në kuadër të përmirësimit (upgrade) të sistemeve AIPS dhe AECH, të cilat operohen nga Banka e Shqipërisë, për t'i sjellë këto sisteme në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Gjithashtu, në kuadër të plotësimit të infrastrukturës bazë të tregjeve financiare, Banka e Shqipërisë po punon për krijimin e Sistemi Qendror të Shlyerjes dhe Regjistrimit të Titujve, i cili do të krijojë mundësinë për zhvillimin e mëtejshëm të tregut sekondar dhe do të garantojë shlyerjet e transaksioneve në këtë treg, në përputhje me standardet më të mira të tregjeve ndërkombëtare.

Së fundi, në kuadër të nxitjes së përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike dhe reduktimit të përdorimit të parasë fizike në ekonomi, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë hapa konkrete për implementimin e parasë elektronike dhe të institucioneve të saj edhe në tregun shqiptar, bazuar në direktivën 2009/110/EC të Bashkimit Evropian. Implementimi i direktivës jo vetëm zgjeron gamën e instrumenteve të pagesave në tregun shqiptar, por njëkohësisht nxit konkurrencën në këtë segment të tregut. Gjithashtu, krijimi i kësaj mënyre alternative pagese, e cila nga eksperiencia ndërkombëtare mund të gjejë aplikim në një spektër të gjerë nevojash për pagesa, vlerësohet të ndihmojë dhe në nxitjen e përfshirjes financiare të popullsisë.


Funksionimi i infrastrukturës bazë të pagesave kombëtare në lekë ka reflektuar siguri dhe efikasitet

Edhe gjatë vitit 2013, funksionimi i infrastrukturës bazë të pagesave kombëtare

në lekë ka reflektuar siguri dhe efikasitet, karakteristika këto të domosdoshme për përmbushjen e objektivit ligjor të Bankës së Shqipërisë në fushën e sistemeve të pagesave, duke kontribuar kështu në mbështetjen e implementimit me efikasitet të politikës monetare, ruajtjen e stabilitetit financiar, si dhe të besueshmërisë së publikut në monedhën kombëtare.


Sistemet e operuara dhe të administruara nga Banka e Shqipërisë: "Sistemi i Shlyerjes së Pagesave ndërbankare me Vlerë të Madhe – AIPS" dhe "Sistemi i Klerimit të Pagesave me Vlerë të Vogël – AECH", kanë funksionuar në përputhje me rregullat dhe procedura përkatëse, duke mos reflektuar devijime të rëndësishme nga oraret e parashikuara për shlyerje e klerim dhe në mungesë të situatave të jashtëzakonshme. Në fund të vitit 2013, të gjitha bankat tregtare që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë rezultojnë të jenë pjesëmarrëse të drejtpërdrejta të sistemeve. Gjithashtu, duke filluar nga viti 2011, pjesëmarrëse e tërthortë në këto sisteme është edhe Ministria e Financave, e cila në sistemin AECH konsiderohet si gjeneruesi kryesor i pagesave, me peshë rreth 73% të totalit të transaksioneve, ndërkohë që në sistemin AIPS, si rrjedhojë e natyrës së sistemit, peshë e transaksioneve vlerësohet me rreth 25% e totalit të pagesave.

Grafik 27. Ecuria e transaksioneve të procesuara në sistemin AIPS në vlerë dhe në numër.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 28. Ndryshimet vjetore (2013-2012) të llojeve të transaksioneve të shlyera në AIPS, sipas numrit dhe vlerës.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

ECURIA E SISTEMEVE AIPS DHE AECH

Treguesit statistikorë të aktivitetit të sistemit AIPS dhe AECH reflektojnë një prirje në rritje, si në numër ashtu edhe në vlerë, gjatë vitit 2013. Zhvillimet në aktivitetin e dy sistemeve janë materializuar në kushte të kënaqshme të likuiditetit në treg.

AIPS - SISTEMI I SHLYERJES SË PAGESAVE NDERBANKARE ME VLERË TË MADHE

Përgjatë vitit 2013, në sistemin AIPS janë procesuar 86,350 transaksione me vlerë mesatare për transaksion 80 milionë lekë, duke reflektuar një rritje të numrit të transaksioneve, si në numër ashtu edhe në vlerë, përkatësisht me 12% dhe 2%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në një perspektivë afatgjatë, likuiditeti në qarkullim në sistemin AIPS ka vijuar prirjen në rritje, duke prekur, në vitin 2013, nivelet më të larta të numrit dhe të vlerës së transaksioneve të procesuara që nga krijimi i sistemit. Shpërndarja e transaksioneve sipas tipologjisë në sistemin AIPS, dikton për një kontribut të qenësishëm në shtimin e transaksioneve të procesuara, si në terma të vlerës ashtu edhe në terma të volumit, të zërave "Pagesat ndërbankare" dhe "Pagesat për klientët", në një kohë që zëri "Instrumentet financiare të B.Sh-së" vijon të reflektojë rënie edhe gjatë vitit 2013.

Zhvillimet e sipërcituara, nga perspektiva e "Pagesat për klientët" vlerësohet të reflektojnë përçimin e masave* të marra nga Banka e Shqipërisë, për nxitjen e përdorimit të sistemeve të pagesave AIPS dhe AECH. Ndërkohë, ecuria e zërave "Pagesat ndërbankare" dhe "Instrumentet financiare të BSH-së" reflektojnë kushtet e likuiditetit të tregut ndërbankar.

Treguesi i përqendrimit, i cili mat peshën që zënë 4 bankat më aktive të sistemit ndaj totalit të aktivitetit të AIPS, për vitin 2013, rezulton 56.88% në numër dhe 68.68% në vlerë. Krahasuar me vitin 2012, ku përqendrimi në terma të volumit rezultonte 51.38%, vërehet një rritje e lehtë, ndërkohë që në terma të vlerës

ky tregues ka ardhur në rënie (73.34%, në vitin 2012).

Numri i rasteve të Kredisë Brenda Ditës** të përdorur gjatë vitit 2013, u rrit në 264 për një vlerë totale 252.5 miliardë lekë. Krahasuar me vitin e kaluar, kjo ecuri nënkupton një rritje të vlerës në masën 178% dhe një rritje të lehtë të numrit të kredive të disbursuara me 2%. Nevojat për likuiditet rezultojnë të kenë qenë të përqendruara në kohë dhe segmente të kufizuara, duke mos reflektuar sjelljen e tregut në tërësi.

* Me vendim nr.12, datë 23.02.2011 Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi- Për sistemin AECH: rritjen e vlerës kufi nga 1 milion – 1.5 milionë të sistemit AECH, shtimi e një seance të tretë klerimi në sistemin AECH, diferencimi i tarifave përgjatë seancave dhe reduktimin e komisioneve dhe tarifave për këtë sistem si dhe përcaktimin e një vlere maksimale prej 500 lekë për komisionet të cilat mund të aplikojnë bankat për shërbimet e pagesave në lekë të kleruara në AECH. Për sistemin AIPS: reduktimin e komisioneve dhe tarifave për këtë sistem si dhe përcaktimin e një vlere maksimale prej 1 500 lekë për komisionet të cilat mund të aplikojnë bankat për shërbimet e pagesave në lekë të kleruara dhe të shlyera në AIPS.

** Kredia brenda ditës përfaqëson një instrument huadhëniejeje për bankat tregtare, me afat më të vogël se një ditë pune. Qëllimi i kredisë brenda ditës është plotësimi i nevojave të bankave për likuiditet brenda ditës dhe garantimi i vijueshmërisë normale të funksionimit të sistemit ndërbankar të pagesave.


Pavarësisht rritjes së konsiderueshme të vlerës absolute të këtij instrumenti, në terma relativë, nevojat për mbulim të transaksioneve totale të procesuara në sistemin AIPS me KBD kanë prekur nivelin më të ulët historik që nga krijimi i këtij sistemi, duke reflektuar reduktim të rrezikut të likuiditetit. Vlerë të shtuar në minimizimin e rrezikut të likuiditetit, vlerësohet të sjellin dhe risitë e aplikuar nga përmirësimi (upgrade) në sistemin AIPS, ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2013, dhe që do jenë të aplikueshme në ambientin live brenda muajve të parë të vitit 2014.

AECH – SISTEMI I KLERIMIT TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL

Në sistemin AECH klerohen pagesat me vlerë nën 1.5 milionë lekë. Përgjatë vitit 2013, në sistemin AECH u procesuan 363,507 urdhërpagesa, me një vlerë totale prej 72,7 miliardë lekësh, duke reflektuar një rritje vjetore prej 0.54% në terma të volumit dhe 8.62% në terma të vlerës. Kontribut të rëndësishëm në shtimin e transaksioneve të kleruara në sistemin AECH duket të kenë sjellë transaksionet e iniciuara nga bankat tregtare për llogari të klientëve të tyre, si dhe, deri diku, transaksionet e iniciuara nga Banka e Shqipërisë për shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve (përfshirë dhe nëpunësit e Bankës së Shqipërisë). Transaksionet e iniciuara nga bankat tregtare (të cilat zënë një peshë prej mesatarisht 23% të totalit) dhe ato të iniciuara nga Banka e Shqipërisë (e cila zë një peshë mesatarisht prej 3% ndaj totalit) kanë pësuar një rritje përkatësisht me 40% dhe 36%. Ashtu si dhe në sistemin AIPS, shtimi i transaksioneve ndërbankare nga bankat tregtare, për llogari të klientëve, vlerësohet të reflektojë përcimin e masave *** të marra nga Banka e Shqipërisë, në kuadër të nxitjes së përdorimit të transaksioneve ndërbankare. Pasqyrimi i pagesave të kleruara në sistemin AECH përgjatë seancave tregon për një shpërndarje të transaksioneve pothuajse të njëtrajtshme në seancën e parë dhe të dytë, dhe një reduktim të fluksit në seancën e tretë dhe të fundit. Zhvillimi i lartpërmendur reflekton masat *** e marra nga Banka e Shqipërisë në shkurt të vitit 2011, të cilat synojnë shmangien e mbingarkesave në flukset e pagesave në seancën e fundit të klerimit dhe si rrjedhojë, minimizimin e rreziqeve shtese mbi mirëfunksionimin e sistemeve të pagesave.


Në terma të përqendrimit të aktivitetit të sistemit AECH, 4 bankat më aktive në këtë sistem rezultojnë të zënë një peshë prej 60.91% në numër dhe 70.90% në vlerë, duke reflektuar një rritje të këtij treguesi, krahasuar me vitin 2012 (ku ky tregues rezultonte në 59.75% në numër dhe 66.35% në vlerë).

Grafik 29. Ecuria e vlerës së transaksioneve të procesuara në AIPS, si dhe raporti i mbulimit të këtyre transaksioneve me KBD.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 30. Peshat e transaksioneve sipas seancave në AECH për vitin 2013, në vlerë dhe në numër.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

*** Me vendim të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë nr. 12, datë 23.02.2013.

Përdorimi i instrumenteve të pagesave dhe potenciali i përdorimit të tyre tregojnë prirje në rritje.

Statistikat e përfuara nga bankat tregojnë një prirje në rritje të përdorimit të instrumenteve të pagesave, si dhe të potencialit të përdorimit, e reflektuar në rritjen e llogarive rrjedhëse dhe të përqindjes së këtyre llogarive të aksesueshme nga internetit. Në fund të vitit 2013, numri i llogarive rrjedhëse të klientëve në monedhë kombëtare apo në valutë, ka pasqyruar një rritje prej 7.1%. Vlen për tu theksuar se gjatë këtij viti është dyfishuar numri i llogarive të klientëve të aksesueshme nga interneti.

Gjatë vitit 2013 janë kryer rreth 8.7 milionë pagesa klientësh me një vlerë totale prej 3,624 miliardë lekësh, duke reflektuar një rritje vjetore të numrit me 9% dhe një rënie të vlerës me 5% krahasuar me vitin 2012.

Tabelë 10. Pësja e pagesave të klientëve, sipas instrumentit të pagesës, gjatë 3 viteve të fundit.

Shërbime pagesash për klientët	Viti 2012		Viti 2013	
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë
I. Transferta Kreditimi të Klientëve	75.50%	95%	74%	97%
nga te cilat:				
1. Transfertë krediti formë letër	96.40%	96.69%	95%	97.12%
2. Transfertë krediti në formë joletër	3.50%	3.32%	5.00%	2.88%
II. Pagesat me karta në POS	12.70%	0.36%	17.25%	0.35%
nga të cilat:				
1. Pagesat me karta debiti	59.20%	35.30%	57.78%	45.87%
2. Pagesat me karta krediti	40.70%	64.60%	42.22%	54.13%
III. Debitimi Direkt	6.40%	0.10%	7.76%	0.61%
IV. Çeqet	0.72%	2.20%	0.57%	2.35%
Totali Pagesave (I+II+III+IV) mld lekë	8,316,444	3,633,448	8,674,708	3,624,336.64

Burimi: Banka e Shqipërisë (Raportimet nga bankat, sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave").

Kohët e fundit, shërbimet "home banking" po marrin një shtrirje gjithnjë e më të madhe në tregun shqiptar. Pas prezantimit të këtij produkti, në vitin 2005, nga një bankë e sistemit, në fund të vitit 2013 janë 11 banka që ofrojnë shërbime "home banking". Shtimi i numrit të llogarive rrjedhëse të klientëve të aksesueshme nga interneti është shoqëruar me një rritje të numrit të transaksioneve "home banking" me 37%, krahasuar me vitin 2012.


Viti 2013 ka shënuar një rritje prej 5% të numrit të kartave në qarkullim, krahasuar me vitin e kaluar. Nga ndarja e kartave sipas funksionit, vihet re një rritje më e përshpejtuar e kartave me funksion krediti, krahasuar me ato me funksion debiti, ndonëse këto të fundit mbajnë peshën më të madhe në totalin e kartave në qarkullim (92%).

Rritja e numrit të kartave bankare (debiti dhe krediti) është shoqëruar edhe nga një rritje e transaksioneve me karta, ku peshën kryesore vijojnë ta zënë transaksionet për tërheqje cash. Gjatë vitit 2013, janë procesuar rreth 13.2 milionë transaksione me karta (ATM dhe POS) me një qarkullim total prej 130 miliardë lekësh. Nga totali i transaksioneve, rreth 88.7% përbëjnë tërheqje cash nga ATM-të dhe vetëm 11.3% janë pagesa klientësh me karta në POS-e.

Pagesat me karta në terminale POS tregojnë për një mbizotërim të numrit të transaksioneve të kryera nëpërmjet kartave të debitit me rreth 57.8%, megjithatë në terma të vlerës, transaksionet me karta krediti paraqiten ndjeshëm më të larta se ato me karta debiti.

Analizimi i infrastrukturës së ofruar nga bankat e licencuara si emetuese³⁴ kartash për vitin 2013, dikton për një rënie të lehtë të numrit të ATM-ve me 0.12% në terma vjetorë. Nga ana tjetër, numri i POS-eve të ofruara nga bankat e licencuara si pranuese³⁵ kartash ka shënuar një rritje prej 7%.

Grafik 31. Zhvillimet e ATM-ve dhe POS-eve (majtas), si dhe numrit të kartave sipas funksionit (djathtas), për periudhën 2004 -2013.



Burimi: Banka e Shqipërisë (raportimet nga bankat sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave").

Ndërmarrja e zhvillimeve infrastrukturore të sistemit bankar në kuadër të mbështetjes së tregtisë elektronike në Shqipëri është materializuar në krijimin për herë të parë të POS-eve virtuale³⁶ në tregun shqiptar. Krijimi i këtyre terminaleve vlerësohet të nxisë përdorimin e pagesave me kartë dhe si rrjedhojë, të reduktojë përdorimin e parasë fizike. Nga raportimet e bankave rezulton se në fund të vitit 2013, në tregun shqiptar operojnë tre POS-e virtuale.

³⁴ Numri i bankave të licencuara si emetuese kartash në Republikën e Shqipërisë, në fund të vitit 2013, rezulton 14. Këto banka ofrojnë shërbime të tërheqjes cash nga ATM-të.

³⁵ Në fund të vitit 2013, 7 banka rezultojnë njëkohësisht të licencuara edhe si pranuese kartash. Këto banka ofrojnë shërbimin e pranimit të pagesave me karta nëpërmjet pajisjeve POS të vendosura në dyqane, restorante, hotele dhe qendra tregtare.

³⁶ Pajisja është e ngjashme me atë të përdorur në shërbime me terminale POS. Ajo mundëson kryerjen e transaksioneve nëpërmjet internetit ose telefonave, me anë të kartave bankare që punojnë në regjim online.